



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË
VENDIM

Nr 14 Datë 10.05.2007

PËR
MIRATIM FONDI PREJ 274 314 LEKË DHE NENSHKRIMIN E
MARREVESHJES PER NGRITJEN E BIBLIOTEKAVE NE
SHKOLLAT 9-VJEÇARE

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Sektori i Koordinim-Zhvillimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë dhe Drejtoria e Financës për " MIRATIM FONDI PREJ 274 314 LEKË DHE NENSHKRIMIN E MARREVESHJES PER NGRITJEN E BIBLIOTEKAVE NE SHKOLLAT 9-VJEÇARE", bazuar në ligjin nr 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32 pika "dh" dhe neni 11. pika 3 a. ligjin nr 8399 dt. 09.09.1998 "Për buxhetin lokal" neni 6, Udhëzimin nr 2 dt. 17.01.2007 i M.F. "Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2007". Udhëzimin nr 353 dt. 19.03.2007 të Ministrisë së Brendshme "Për zbatimin e Buxhetit të Qeverisjes Vendore për vitin 2007". V.K.B. nr 2, dt 02.02.2007 "Mbi miratimin e Buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve në vartësi për vitin 2007":

VENDOSI

1. Të miratojë fondin prej 274 314 lekë dhe nenshkrimin e marreveshjes për ngritjen e bibliotekave në shkollat 9-vjeçare "Sevasti Qirjazi", "Sotir Gura" dhe "Stavri Themeli".
2. Ky fond do të përballohet nga fondi rezervë i të ardhurave të Bashkisë me këtë strukturë buxhetore :

Pakesohet	00	04980	05	Art	6091100	- 274314
Shtohet	00	01110	05	Art	6044099	+274314
3. Kontributi i Bashkise per ngritjen e 3 bibliotekave pas nenshkrimit te marreveshjes, do ti kaloje Fondacionit MJAFT, me adrese Rr "Mustafa Matohiti", Nr.4, Tirane; me Nr. Nipti K52325004B; Credins Bank. Dega Credins Bank – Tirana; BIC/SWIFT CDISALTR; Nr. Llogarise (lek) 10606.
4. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Drejtoria e Finances, Drejtoria Mbeshtetese e Arsimit dhe Sektori i Koordinim-Zhvillimit dhe Marredhenieve me Jashte.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare e Këshillit

Rajmonda NASE